



I dyshuari pranon se ka armë të gjatë në shtëpi, kjo erdhi nga hetimi i Policisë me një rast të kanosjes



19/06/2024 18:38 [f](#) [t](#) [l](#)

Policia e Kosovës gjatë intervistimit të një personi me një rast të kanosjes, i njëjti ka pranuar se kishte një armë zjarri automatike në posedim të paautorizuar (pa lejet përkatëse ligjore).

Gjatë intervistimit i dyshuari ka pranuar se posedon armë zjarri të tipit AK-47 me 78 copë fisheke, raporton [lajmi.net](#).

Postimi i plotë:

Stacioni Policor në Rahovec, gjatë një interviste të një të dyshuar (mashkull kosovar i moshës madhore), lidhur me një rast të kanosjes, i njëjti ka pranuar se kishte një armë zjarri automatike në posedim të paautorizuar (pa lejet përkatëse ligjore).

Duke vepruar menjëherë mbi këtë informacion, zyrtarët policorë, në bashkëpunim me prokurorin e shtetit, kanë kryer kontroll në vendbanimin e të dyshuarit në rrugën “Bekim Isma” në Rahovec. Kontrolli ka rezultuar me sekuestrimin e armës automatike ilegale dhe shtatëdhjetë e tetë (78) copë fisheke.

Me vendim të prokurorit të shtetit është iniciuar rast “mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës”, ndërsa rasti mbetet të trajtohet në procedurë të rregullt. [/Lajmi.net/](#)



Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LajmiMedia



Artikuj të ngjashëm




June 20, 2024
Ikja e të rinjve, Gërxhaliu i reagon Bislimit: Kjo e prek...



June 20, 2024
“Krejt dhe drejt nuk është kryeministër”, banorët e Shipitullës protestojnë për...



June 20, 2024
Nis fushata vetdijësuese nga Policia e Kosovës “Festo me zemër jo...



June 20, 2024
Dysshohet për mjet shpërthyes në rrugën “Shpëtim Robaj” në Prishtinë



June 20, 2024
Bislimi mori pjesë në festën e ditëlindjes së Mbretit Charles II:...



June 20, 2024
Gjuria: Kurti s'po pengohet, krijimi i një shoqërie multietnike në Kosovë...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

Other Links

[Fact-Checking Policy](#)
[Ethics Policy](#)
[Corrections Policy](#)
[Ownership & Funding Information](#)
[Editorial Team Information](#)

RRJETET SOCIALE